



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

Shkurt, 2018r.

Nr. 02/2018

Përfaqësues të OSBE/ODIHR për vizitë pune në Agjenci



Delegacioni i OSBE/ODIHR, i udhëhequr nga zëvendës shefi i seksionit për zgjedhje, Riçard Lapin si dhe këshilltarja për zgjedhje në OSBE/ODIHR Tamara Otiashvilli, më 22 shkurt ishin në vizitë pune të Agjencisë, ku u prezantua raporti final i Misionit mbikëqyrës për zgjedhjet lokale, të mbajtura më 15 dhe 29 tetor 2017. Mes tjerash, në Raportin është theksuar se “ASHMAA e ka treguar profesionalizmin e vet gjatë zgjedhjeve, duke realizuar në tërësi mandatin e vet”.

Në takim u shkëmbyen përvojat e nga monitorimi i prezantimit mediatik zgjedhor që u realizua nga Agjencia, kurse u bisedua edhe për propozimet e Agjencisë lidhur me ndryshimin e rregullativës zgjedhore. Theks i veçantë i takimit ishte edhe propozim-ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, ku Agjencia përsëri potencoi se ndryshimet e propozuara e çenojnë pavarësinë e rregullatorit dhe nuk kontribuojnë për përmirësimin e gjendjes në sferën mediatike.

Mendimi nga Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi në aspekt të parashtresës për mizogini dhe seksizëm të programeve në tre radiostacionet


Në lidhje me parashtresën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, lidhur me fushatën e përbashkët të prodhimit të tyre, te Siti Radio, Klub FM dhe Metropolis Radio Mrezha, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi në RM, ka dorëzuar deri te Agjencia një shkresë - mendim me të cilin konstatohet shqetësimi në bazë gjinore i bërë nga ana e Siti Radio, e që ka shkaktuar shkelje të dinjitetit të gruas, me spotet për fushatën e grave të tej emancipuar, që është emetuar më 30 tetor 2017.

Shkresa nga Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi në RM mund të merret në ueb faqen e Agjencisë.

Reagimi i Agjencisë – Gazetarëve t'u mundësohet kryerje e lirë e punës

Në lidhje me reagimin e TV 21 se një gazetar i tyre është penguar që të parashtrojë pyetje në një konferencë për shtyp në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Agjencia përmes këtij njoftimi potencon se është e domosdoshme që gazetarët të munden ta kryejnë punën e tyre, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje me interes publik.

Agjencia përkujton se roli i medimeve dhe transparenca e institucioneve ndaj tyre është me rëndësi kyçe për shoqëritë bashkëkohore demokratike, sepse vetëm në atë mënyrë mundësohet hapje dhe pjesëmarrje në debate më të gjera publike, krijimit të lirshëm të mednimit publik si dhe formimit të qëndrimeve kritike.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

Mbikëqyrje të radiodifuzerëve

Agjencia realizoi një mbikëqyrje të rregullt programore ndaj RTM1 dhe RTM 2, lidhur me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me obligimet për plotësimin e kuotës për program të krijuar burimor; përdorimin e gjuhës në përmbajtjet programore; rregullat për mbrojtjen e publikut të mitur; sponsorisimeve dhe teknikave të tjera reklamuese; obligimeve gjatë sigurimit të kuizeve ose formave tjera të pjesëmarrjes shpërblyese; si dhe për shfrytëimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar ose votimit telefonik. Mbikëqyrja tregoi se RTM 1 dhe RTM 2 nuk e kanë plotësuar kuotën për program të krijuar burimor në RM, kurse për mosrespektimin e këtij obligimi u shqiptua masa e vërejtjes. Ndaj shërbimeve programore RTM 1 dhe RTM 2, është bërë edhe mbikëqyrje e rregullt administrative lidhur me obligimet që kanë të bëjnë me publikimin e impresumit, informatat për shfrytëzuesit dhe identifikimin e radiodifuzerit, ku nuk janë konstatuar shkelje.

Mbikëqyrje kontrolluese programore dhe administrative u realizuan ndaj disa radiodifuzerëve. Mbikëqyrje kontrolluese programore lidhur me obligimet që kanë të bëjnë me kuotën për emetimin e së paku 50% të programit të krijuar burimor në RM në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive joshumicë, i cili u realizua ndaj TV Alsat-M, TV Telma dhe TV Art Çannel. Mbikëqyrja tregoi se këto medime në tërësi kanë vepruar sipas masës së shqiptuar paraprake. Lidhur me obligimet gjatë emetimit të kuizeve ose formave tjera të pjesëmarrjes shpërblyese, u realizua edhe një mbikëqyrje kontrolluese ndaj TV Alfa, ku u konstatua se në tërësi është vepruar sipas masës paraprake. Mbikëqyrje për respektimin e obligimit për plotësimin e kuotës për muzikën e emetuar, që u krye ndaj TV Nova, ku u konstatua se televizioni edhe më tutje i shkel dispozitat nga LSHMAA, ku edhe u shqiptua masa e vërejtjes. Agjencia realizoi edhe mbikëqyrje kontrolluese administrative ndaj TV Telma dhe TV Art Çannel, me qëllim që të konstatohet nëse është menjanuar shkelja për të cilën lidhet obligimi për publikim të impresumit. Mbikëqyrja konstatoi se të dy radiodifuzerët në tërësi kanë vepruar sipas masës së shqiptuar paraprake. Si pjesë shtesë ndaj TV Art Çannel u realizua edhe një mbikëqyrje kontrolluese me qëllim që të konstatohet nëse janë siguruar informata që duhen të jenë në dispozicion të shfrytëzuesve. Për mospësigurimin e këtyre informatave ndaj TV Art Çannel është shqiptuar masa e vërejtjes.

Mbikëqyrja ndaj operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik


Agjencia realizoi një mbikëqyrje të rregullt programore ndaj operatorëve kabllor VINSAT KABEL nga Vinica, INFEL-KTV nga Ohri, KABEL-NET nga Strumica, NEOTEL nga Shkupi, PET NET nga Gjevgjelia dhe ALTRA-SAT 2000 nga Ohri, në lidhje me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me obligimet për titrimin në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësisë që nuk është shumicë në RM si dhe për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci.

Me mbikëqyrjen u konstatua se operatorët kabllor kanë vepruar sipas dispozitave të LSHMAA. Ndaj operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik Total TV nga Shkupi, Agjencia realizoi një mbikëqyrje kontrolluese programore për të konstatuar nëse ka vepruar sipas masës së shqiptuar më herët, për ritransmetimin e shërbimeve programore që nuk janë të regjistruara në Agjenci. Mbikëqyrja tregoi se operatori në tërësi ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Mbikëqyrja ndaj medimeve të shtypit

Agjencia realizoi një mbikëqyrje të rregullt administrative ndaj 28 medimeve të shtypit me qëllim që të konstatohet nëse të njëjtit kanë publikuar të dhëna për selinë, redaksinë, shtypshkronjën, tirazhin dhe datën e botimit ose ribotimit. Me mbikëqyrjen është konstatuar se 26 medime të shtypit e kanë plotësuar obligimin nga Ligji për medime, ndërsa pjesërisht e kanë plotësuar vetëm medimet Hrana i vino dhe Shenja.

Mbikëqyrje kontrollues administrative, Agjencia realizoi edhe ndaj IV-AN PRINT 16 publikues të magazinës "Shtipski gllas" dhe ndaj JENI BALLKAN publikues të magazinës "Bahçe", me qëllim që të konstatohet nëse kanë vepruar sipas vendimit për masën e vërejtjes, të shqiptuar për mosplotësimin e obligimit për shpalljen e të dhënave për selinë, redaksinë, shtypshkronjën, tirazhin dhe datën e botimit ose ribotimit. Të dy mediet e shtypit në tërësi kanë vepruar sipas masës së shqiptuar paraprakisht nga Agjencia.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

rr. Maqedonia nr. 38, 1000 Shkup

Tel. (02) 3103400 faks: (02) 3103401

e-posta: contact@avmu.mk ueb faqja: www.avmu.mk

